



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.nr.3/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 05.02.2024 të parashtruar nga ankuesja K [REDACTED] A [REDACTED]-S [REDACTED], avokate nga Gjilani, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës M [REDACTED] A [REDACTED] - gjyqtare në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Gjilani dhe zyrtarit ligjor N [REDACTED] I [REDACTED], më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga ankuesja K [REDACTED] A [REDACTED]-S [REDACTED], avokate nga Gjilani, e datës 05.02.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarës M [REDACTED] A [REDACTED] - gjyqtare në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Gjilani dhe zyrtarit ligjor N [REDACTED] I [REDACTED].

A r s y e t i m

K [REDACTED] A [REDACTED]-S [REDACTED], avokate nga Gjilani, më datë 05.02.2024 ka paraqitur parashtresë, të cilën e ka emërtuar dyshim për parregullsitë e bëra nga zyrtari ligjor N [REDACTED] I [REDACTED] dhe gjyqtarja e çështjes M [REDACTED] A [REDACTED].

Në parashtresë, e njëjta ka theksuar se më datë 14.11.2023 ka pranuar aktvendimin e kësaj gjykate, CPK.nr.52/22, P.nr.50/22, si e autorizuar e debitorit A [REDACTED] S [REDACTED] sipas kësaj çështje përmbarimore, ndërsa më datë 01.12.2023 ka pranuar ankesën ndaj këtij vendimi nga kreditori Forma Sh.P.K. Sipas informatës së pranuar nga zyrtari ligjor N [REDACTED] I [REDACTED] lënda së bashku me ankesën, më datë 15.01.2024 ka shkuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Me aktvendimin në fjalë është pranuar prapësimi i debitorit dhe është shfuqizuar urdhri përmbarimor, e në vazhdimësi ka kërkuar nga zyrtari ligjor ecurinë e procedurës dhe faktin nëse kreditori ka ushtruar ankesë. Nga zyrtari ligjor ka marrë njoftimin se është ushtruar ankesë nga kreditori, mirëpo kur është pyetur për datën e ushtrimit të ankesës, i njëjti i ka deklaruar se nuk kemi pranuar fletëkthesën nga posta se kur është pranuar vendimi nga kreditori. Në një ditë, në fund të muajit dhjetor, ka shtuar se ka parë në këtë lëndë një fletëkthesë të zbratur, pa nënshkrim dhe datë të pranimit

nga avokati E [REDACTED] S [REDACTED] – i autorizuari i kreditorit, ndërsa kur e ka pyetur për këtë zyrtarin ligjor, i njëjti i është përgjigjur se e ka lënë fletëkthesën të zbratur për ta pritur avokatin të nënshkruaj fletëkthesën dhe datën e pranimit në përputhje me datën e pranimit të listës së postës. Me këto veprime, ka konsideruar se zyrtari ligjor ka lejuar avokatin të nënshkruaj fletëkthesën me datë të përshtatshme për të njëjtin, ndërsa ka shprehur dyshime se ankesa është dorëzuar pas 7 ditësh dhe lënda përsëri është dërguar në gjykatën e shkallës së dytë, pa u ndërmarrë veprimet ligjore në përputhje me nenin 186.1 dhe 2 dhe nenin 188 të LPK-së. Për këto veprime të dërgimit të lëndës, ka shprehur dyshimet edhe për gjyqtaren e çështjes.

Këtë parashtrësë, kryetari i gjykatës si autoritet kompetent, e trajtoi si ankesë të parashtrueses ndaj veprimeve të gjyqtarës dhe zyrtarit ligjor për iniciimin e procedurës disiplinore dhe i ka kërkuar gjyqtarës së çështjes, si dhe zyrtarit ligjor që të deklarohen lidhur me pretendimet e ankueses.

Gjyqtarja M [REDACTED] A [REDACTED] në deklaratën e saj të datës 29.02.2024 ka theksuar se në këtë gjykatë është duke u zhvilluar procedura përmbartimore e paraqitur nga kreditori Forma Sh.P.K., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E [REDACTED] S [REDACTED] avokat nga Vitia, ndaj debitorit A [REDACTED] S [REDACTED] nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K [REDACTED] A [REDACTED] S [REDACTED] avokate nga Gjilani. Këtë lëndë e ka kontrolluar sipas ankesës të paraqitur nga i autorizuari i kreditorit dhe ankesa ka qenë në afat, e zakonisht të gjitha lëndët me ankesë i kontrollon paraprakisht lidhur me afatin e parqitjes, e më pas e përcjell lëndën përmes shkrimoreve të referenti përkatës që të procedohet lënda tutje. Meqë lënda gjendet në Gjykatën e Apelit, nëse eventualisht është bërë ndonjë lëshim teknik sa i përket afatit, nuk mund ta dëshmojë me provë përkatëse, por edhe në rast se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor, gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare për afatin e ankesës.

Zyrtari ligjor N [REDACTED] I [REDACTED] në deklaratën e tij të datës 29.02.2024 ka theksuar se ka pritë nga shërbimi i ekspeditimit fletëdorëzimin e pranuar nga ana e postës, por e njëjta është vonuar, ndërsa ankesa ka ardhë në ndërkohë e është ekspeduar, me ç'rast ka ardhë edhe përgjigja në ankesë. Meqë ka qenë fundi i muajit dhjetor dhe ka caktuar pushimin vjetor, lëndën e ka evidentuar me një notes (shënim) që të mos dërgohet për Gjykatën e Apelit pa u kompentuar me fletëdorëzim. Ka dorëzuar si provë listën e ekspeditimit të lëndëve ku figuron se të avokati E [REDACTED] S [REDACTED] në Viti, më datë 17.11.2023 është ekspeduar vendimi CPK.nr.52/22 dhe të dhënat në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (smil), ku figuron se më datë 06.12.2023 është pranuar ankesa (shqyrto dokumentin e pranuar).

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës, analizimit me shumë kujdes të pretendimeve të palës ankuese dhe deklarimit të gjyqtarës së çështjes e zyrtarit ligjor, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë më ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, ngase sipas vlerësimit të kryetarit të kësaj gjykate, ankesa e palës ankuese e dt. 05.02.2024, është e pabazuar dhe pretendimet në të nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës erdhi pasi në rastin konkret dyshimet e të autorizuares së debitorit nuk gjejnë mbështetje në asnjë provë. Kryetari i gjykatës ka parasysh se dërgimi i vendimeve jashtë komunës së Gjilanit që duhet të ekspedohet nga zyrtarët e postës ka hasur shpesh në vonesa dhe parregullësi dhe kjo nuk përbën rastin e parë, por të shpeshtë kur fletëkthesat e postës nuk i

kthehen gjykatës fare, apo pas një kohe tepër të gjatë. Meqë zyrtari ligjor ka pranuar ankesën, pa e marrë ende fletëkthesën për pranimin e vendimit nga ana e të autorizuarit të kreditorit, veprimet e tij të ndërmarra për kompletim të lëndës nuk përbëjnë shkelje disiplinore, meqë i njëjti në rastin konkret është siguruar në plotësimin e kushteve ligjore për procedim të lëndës në gjykatën e shkallës së dytë.

Sa i përket faktit se gjyqtarja e çështjes ka bërë shkelje disiplinore për dorëzim të lëndës në gjykatën e shkallës së dytë, edhe pse ankesa e kreditorit dyshohet të jetë jashtë afatit ligjor, kryetari i kësaj gjykate nuk u lëshua fare në këtë pretendim, meqë për ankesë jashtë afatit ligjor bazuar në dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore ka kompetencë të vendos edhe gjykata e shkallës së dytë. Këto pretendime ndaj gjyqtarës së çështjes, kryetari i kësaj gjykate i vlerësoi pretendime përkitazi me mjetet juridike me të cilat atakohen vendimet e gjykatës, e që nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

Meqë pretendimet e parashtrueses së ankesës janë të njëjta, lidhur me lëndën e njëjtë dhe procedurën e njëjtë, kryetari i kësaj gjykate për hir të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore, i trajtoi këto ankesa bashkërisht ndaj gjyqtarës së çështjes dhe zyrtarit ligjor, e të njëjtat i gjeti të pabazuara, përkatësisht nga provat vërtetoi se nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e ankueses K [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR]-S [REDAKTUAR], avokate nga Gjilani, e datës 05.02.2024, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës,
Vehnar Sahihu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarës M [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR],
2. Zyrtarit ligjor N [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR],
3. Parashtruesit të ankesës,
4. KGJK-së,
5. Dosjës së lëndës.